

Koordinatori Kombëtar Antitrafik

Buletin

Nr. 17

Informativ

Shtator -Nëntor-

Dhjetor 2018

Trajnim i “Përdorimit të teknologjisë së Informacionit në Luftën kundër Trafikimit të Personave”

Më datat 17-18 shtator, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në bashkëpunim me OSBE-në, në Akademinë e Sigurisë zhvilluan trajnimin me temë “Përdorimi i teknologjisë së informacionit në luftën kundër trafikimit të personave”, me pjesëmarrjen e 20 efektivëve të policisë.



Takim me temë
“Përmirësimi i sistemit të

mbrojtjes së fëmijëve të shfrytëzuar për punë në vendet fqinjë”

Më datë 27 shtator, në Prizren u zhvillua tryeza e 3-të me temë “Përmirësimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve të shfrytëzuar për punë në vendet fqinjë”, në të cilën morën pjesë përfaqësues të strukturave shtetërore të qarkut Kukës dhe një grup me përfaqësues nga Kosova që ofrojnë shërbime për fëmijët



Trajnimi I Kombëtar mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore, 24-28 Shtator 2018, Akademia e Sigurisë

Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim me FRONTEX dhe IOM, më datë 24-28 shtator, në Akademinë e Sigurisë zhvilluan trajnimin i I Kombëtar i Trafikimit të Qenieve Njerëzore, në zbatim të projektit IPA II.



Zyra e Koordinatorit Kombëtar u zhvillua takimi me Oficerin për Raportimet dhe Marrëdhëniet Politike

Zyra e Koordinatorit Kombëtar u zhvillua takimi me Oficerin për Raportimet dhe Marrëdhëniet Politike, Z. Atsuki Takahashi nga Zyra për Monitorimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Personave në Washington dhe Z. Ian Crawford, Oficeri i të Drejtave të Njeriut në Ambasadën Amerikane në Tiranë. Në takim u diskutuan arritjet në fushën e Antitrafikut për vitin 2018 dhe sfidat e shumta në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri. Z. Takahashi shprehu se Shetet e Bashkuara do të vazhdojnë të mbështesin Shqipërinë në punën e mirë që po bëjnë në luftën kundër këtij fenomeni.

“Mbi parandalimin e migracionit të parregullt”.

